

## ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **MINISTRIA E SHËNDETËSIS**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

|                   |                 |
|-------------------|-----------------|
| Nr. i prokurimit: | 206-20-8519-511 |
| Nr i brendshëm    | 206-20-65-515   |

Sa i përket tenderit për: **Adaptimi i Klinikës së Re Emergjente për nevoja të Covid-19**

### 1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

**IR Project Sh.P.K.**

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Adem Jashari p.n.

(Adresa)

Viti

61000

(Vendi)

(Kodi postar)

044/249-864

N/A

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Korab Ferizi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

irprojectshpk@gmail.com

(Adresa elektronike)

22.01.2021

(Data e parashtrimit të kërkesës)



(Nenshkrimi dhe viti)

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

\_\_\_\_\_  
(Emri i avokatit)

\_\_\_\_\_  
(Adresa e plotë)

\_\_\_\_\_  
(Numri i Telefonit)

\_\_\_\_\_  
(Numri i faks-it)

\_\_\_\_\_  
(Adresa elektronike)

\_\_\_\_\_  
(Data e parashtrimit të kërkesës)

\_\_\_\_\_  
(Nënshkrimi dhe vula)

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

**Njoftimi për kontratë: 24.12.2020**

Afati i fundit për dorëzimin e tenderit: 12.01.2021

Njoftimi për sqarim i AK-së: 31.12.2020

Pergjigja ne kerkesen per ri-kerkes: 12.01.2021

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

Po ☐

Jo ☒

Jemi njoftuar përmes sistemi elektronik e-prokurimi.

#### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

Po ☐

Jo ☐

#### 6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

Neni 108/A i i LPP-së, Zgjidhja preliminare e mosmareveshjes

Neni 7 i LPP-së, Barazia në Trajtim / jo –diskrimin

Neni 28 i LPP-së

Neni 51 i LPP-së, Njoftimi i kriterëve Perzgjedhjes

Neni 70 i LPP-së, Standardet për sigurimin e cilesis

Neni 69 i LPP-së, Aftesia teknike dhe/ose Profesionale

Neni 18.16 i RRUOP-së Është e ndaluar përgaditja e Dosjes së Tenderit në një mënyrë që të favorizon ose diskriminon kunder një ose më shume Operator

Ekonomik potencial

Neni 26.8 i RRUOP-së

#### 7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*



Të nderuar ne kemi pranuar njoftimin për kontrat dhe në FTD kemi verejtun se ju si AK- keni bërë shkelje të LPP-së, ku jeni munduar të minimizoni konkurencën për këtë projekt.

**Neni 108/A i i LPP-së, Zgjidhja preliminare e mosmareveshjes**

- *Pase kerkes se pare per ri-shqyrtim shifet se ju keni ngrutun ne sistem Sqarim shtesë ku keni provuar të eni një divijim te vogel mirpo ne substance nuk keni ndryshuar asgja.*

**Neni 7 i LPP-së, Barazia ne Trajtim / jo –diskrimin**

- *Auturiteti Kontraktues ka bërë shkelje të nenit 7 pasi që me kërkesat (9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale ) ka kufizuar konkurencën ose me mire me than qe e ka pershtat per kompani te caktuar sepse kërkesat e kerkuara ne njoftim per kontrate dhe ne DT, jane aq specifika sa qe vetem personi qe i ka kerkuar nga ana e AK-së dhe OE qe i ploteson keto kërkesa nga një bashkepunim paraprak dhe kordinim i plote me njeri tjetrin kan dite ti rendisin ne kete menyre, sepse disa kërkesa as nuk te bajn me projektin ne fjale fare, mirepo jane parapare qe te kufizohet konkurencën ne maksimumin e mundeshme ( me mire kishte me qene qe te shkruhej edhe ne verejtjen per njoftim te kontrates qe lejohet vetem “X” OE te konkuroj)*

Me posht po i renditim kërkesat qe jane diskriminuese dhe e kufizojn konkurencën, kërkesat dhe deshmit si me poshtë.

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare 8.1 & 8.2,

2. Operatori ekonomik duhet te ofroj dëshmi që ka kapacitet financiar për realizimin e projektit ose mbështetje nga ndonjë bankë për ekzekutimin e projektit në vlerë prej së paku 5.0 Milion Euro. *Deshmi e kerkuar:*

2. Deklaratë mbështetëse nga një bankë (Dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar lidhur me këtë projekt).

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale:

b. Se paku dy objekte (kontrata) pune për objekte shëndetësore (Pa llogaritur Objektin Spitalor). Kusht shtesë (i veçantë) është qe ne aktivitetin e tyre ndërtimorë si kompani, te kenë se paku një objekt spitalor te ndërtuar.

10. Ekspert për saldime 10a - Ekspert Saldimi me kualifikimin International Welding Specialist (IWS), për saldime, me përvojë pune ne lëmin e saldimeve se paku 2 vite 10b - Teknik për saldimin e gypave medicinal me përvojë 2 vjeçare.

11. Operativa ndërtimore - me mundësin e angazhimit te min. 250 punëtorë (pa llogaritur stafin profesional te sipër cekur), ne harmoni me specifikat dhe nevojat operative për përmbushjen e planit te kërkuar dinamik (150 dite Kalendarike), përfshi planin specifik te vendosjes se pacientëve ne objektin e spitalit Covid 19, për min. 100 ditë kalendarike, me operative 24/7

Në vazhdim do te elaborojm qe jane te pa nevojshme dhe ne kundershtrim te plote me LPP-në:

**Kërkesa 1.** Operatori ekonomik duhet te ofroj dëshmi që ka kapacitet financiar për realizimin e projektit ose mbështetje nga ndonjë bankë për ekzekutimin e projektit në vlerë prej së paku 5.0 Milion Euro. *Deshmi e kerkuar:*

2. Deklaratë mbështetëse nga një bankë (Dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar lidhur me këtë projekt).

Kjo kërkes eshte e paqendrushme pasi qe projekti kap vlrene e rreth 19 milion/€ i cili projekt ne dosjen e tenderit eshte kerkes qe te kryeht per 100 dite kalendarike me operativ 24/7, AK-ja duhet te njoftoj se sa mjete ka ne zotim ne kete kod per kete Spital, i cili nuk eshte projeksionit e Bugjetin te Rupeblikes se Kosoves, eshte dashte qe ta njofoj lidhur me financimin e ketij projekti pasi qe kerkon puna te kryeht per 100 dite kalendarike OE duhet te kene njohuri sa para jane ne kod te ketij projekti

- Kjo kerkes duhet te hiqet qe te jete konkurence e lire dhe fer.



**Kërkesa 2.** Se paku dy objekte (kontrata) pune për objekte shëndetësore (Pa llogaritur Objektivin Spitalor). Kusht shtesë (i veçantë) është që në aktivitetin e tyre ndërtimorë si kompani, të kenë se paku një objekt spitalor të ndërtuar.

Kjo kërkesë është e pa qëndrueshme pasi ju si MSH e dini me se mirë që në Kosovë këto 20 vite pas luftës nuk është ndërtuar asnjë Objekt Shëndetësor, ku në këtë kërkesë nuk e keni parapare që as renovimet të cilat janë kryer mos të mirren parasysh. Kjo e mundësin kompanive të huaja të vinë në Kosovë vetëm për dokumentacion e cila kërkesë na demton neve si OE. Nuk i ndimon procesit

- Kjo kërkesë duhet të hiqet që të jete konkurrenca e lirë dhe fer.

**Kërkesa 3.** 10. Ekspert për saldime 10a - Ekspert Saldimi me kualifikimin International Welding Specialist (IWS), për saldime, me përvojë pune në lëmin e saldimeve se paku 2 vite 10b - Teknik për saldimin e gypave medicinale me përvojë 2 vjeçare.

Kjo kërkesë është e pa qëndrueshme pasi nuk duhet të kërkohej Ekspert për Saldime e aq me pak IWS, Në UP e as në Universitetin Privat nuk ka asnjë drejtim me kualifikim diplom IWS, për më shumë as Republika e Kosovës nuk është anëtarë në këtë institut, kjo kërkesë nuk përkon me sigurimin e cilesit në realizimin e projektit në fjalë, punët që duhet të kryhen në këtë projekt me saldime janë ndër saldimet me të thjeshta të mundshme të ndërtimitarise, për kontrollimin e cilesit se Saldimeve në Republikën e Kosovës është kompetent Fakulteti i Inxhinjerisë Mekanike pran UP-se

- Kjo kërkesë duhet të hiqet që të jete konkurrenca e lirë dhe fer.

**Kërkesa 4.** Operativa ndërtimore - me mundësin e angazhimit të min. 250 punëtorë (pa llogaritur stafin profesional të sipër cekur), në harmoni me specifikat dhe nevojat operative për përmbushjen e planit të kërkuar dinamik (150 ditë Kalendarike), përfshi planin specifik të vendosjes së pacientëve në objektin e spitalit Covid 19, për min. 100 ditë kalendarike, me operative 24/7

Kjo kërkesë duhet të sqarohet pasi AK-ja ka kërkuar që objektin të ndërtimit të Spitalit Covid të kryhet për 100 ditë kalendarike mirpo nuk e ka cekur burimin e investimit, ku në qarkoren bugetore nuk është as në vitin 2020 edhe atë 2021

Gjithashtu ju si autoritet kontraktues nuk i keni respektuar edhe dispozitat e nenit 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë, kërkojmë nga ju si autoritet kontraktues që të nxjerrni:

## VENDIM

**APROVOHET**, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim të operatorit ekonomik IR Project Sh.P.K.

**ANULOHET**, njoftimi për kontratë të AK-së dhe lënda kthehet në **Ri-shpallje** dhe gjatë rishqyrtimit, ekzaminimit, vlerësimit dhe të bëhet në harmoni me LPP-në kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

|  |
|--|
| <b>Na pamundesohet te konkurojme ne kete projekt</b> |
|--|

#### **9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) Një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) Një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) Një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) Një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*
- e) Paramasat e operatoreve ekonomik*